



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 24, datë 26 .09. 2012

**PËR**

**“RIEMËRTIMIN E NJË PJESE TË RRUGËS “VASO PASHA” ME EMRIN “JANOS HUNYADI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neneve 8, 121, 124 dhe 125 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë riemërtimin e një prej rrugëve të qytetit të Tiranës, me emrin “Janos Hunyadi”, konkretisht të një pjese të rrugës “Vaso Pasha”, nga kryqëzimi i saj me rrugën “Abdyl Frashëri” deri në mbarimin e saj në kryqëzimin me rrugën “Adem Jashari” (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Emërtimi “Vaso Pasha” mbetet në fuqi për pjesën tjetër të rrugës, për segmentin nga Bulevardi “Bajram Curri”, deri në kryqëzimin me rrugën “Abdyl Frashëri”.
3. Në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 29.09.2008 për “Emërtimin e pjesëve të territorit publik të paemërtuara në Bashkinë e Tiranës”, në aneksin 2.1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e vendimit, revokohet emërtimi me nr. rendor 558 “Janosh Hunyadi”, në territorin e Njësisë Bashkiake nr.6.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi .
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I  
NIAZI KOSOVRASTI**